



BULETIN



PËRGJEGJSHMËRIA E DEPUTETËVE DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin informativ / Nr.31

SHTATOR 2006

Projekt i QSP-së për Monitorimin e Veprimtarisë së Parlamentit me Mbështetjen e Fondacionit "Shoqëria e Hapur" SOROS

NGA PUNIMET E KUVENDIT

Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore

Në janar të vitit 2006 Kuvendi, në vijim të angazhimit që partitë parlamentare deklaruan në takimin me Presidentin e Republikës në dhjetor 2005, miratoi projektvednimin për ngritjen e komisionit të posaçëm për reformën zgjedhore. Komisioni, parashikohej të përbëhej nga 22 anëtarë, nga 6 anëtarë për dy partitë e mëdha dhe nga 1 anëtar nga secila parti parlamentare. Partitë e vogla e kontestuan këtë formulë dhe deklaruan se nuk do të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit për Reformën Zgjedhore për shkak të vetos në vendimmarrje të parashikuar për partitë e mëdha. Mazhoranca u shpreh në favor të pretendimeve të partive të vogla duke kërkuar edhe konsensusin e opozitës.

Në muajin maj, 2006 opozita propozon një formulë të re të ndryshme nga ajo e janarit.

Me vendimin Nr.38, datë 18.maj 2006 Kuvendi vendosi me 89 vota pro,

(Vijon në faqen 2)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Këshillin Konsultativ të Biznesit

Relacioni për Projektligjin "Për Këshillin Konsultativ të Biznesit.

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në kuadër të politikave të zhvillimit të ekonomisë dhe të biznesit, i kushton, një vëmendje të veçantë institucionalizimit të dialogut të sektorit publik me atë privat. Nisur nga fakti se Këshilli Konsultativ i Biznesit në Shqipëri është mekanizimi më i lartë i partnershit publik - privat, ku komuniteti i biznesit mund të përfaqësohet dhe të paraqesë shqetësimet e veta për politikën që ndikojnë interesat e tij, bëhet i nevojshëm krijimi i një baze ligjore, që do të sigurojë dhe përmirësojë cilësinë e vazhdueshme të një dialogu të tillë.

Përvoja e deritanishme ka vërtetuar se performanca e këtij institucioni ka qenë e pamjaftueshme, si për anëtarët e Këshillit Konsultativ të Biznesit, ashtu edhe për grupet e biznesit, që ata përfaqësojnë. Mangësi të kësaj

(Vijon në faqen 3)

Në këtë numër do të lexoni:

1. Nga Punimet e Kuvendit Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore

faqe 1-2

2. Projektligje në proces Projektligji "Për Këshillin Konsultativ të Biznesit

faqe 1,3

3. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave për muajin gusht 2006

faqe 4-5

4. Programi i Punimeve të Kuvendit për periudhën 4 shtator - 6 nëntor 2006

faqe 5-6

5. Kalendari 3 javor i Kuvendit të Shqipërisë për periudhën 4 - 25 shtator 2006

faqe 1,7-9

KALENDAR I

3 Javor (4 - 25 shtator 2006) i Punimeve të Kuvendit

Sesioni i III-të

Legjislatura e XVII-të

SEANCË PLENARE

E hënë, datë 04.09.2006, ora 18.00

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').

2. Miratimi i procesverbaleve të Seancave Plenare të datave 27 dhe 28 korrik 2006.

3. Miratimi i Programit të Punës së Kuvendit për periudhën 4 shtator – 6 Nëntor 2006.

(Vijon në faqen 7)

NGA PUNIMET E KUVENDIT

(Vijon nga faqja 1) Komisioni i posaçëm për Reformën Zgjedhore

3 kundër dhe 5 abstenime "Për Nritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore". Sipas këtij vendimi detyrë e Komisionit është përgatitja e amendamenteve të nevojshme të kuadrit ligjor për arritjen e standardeve në zgjedhjet e ardhshme, mbështetur në rekomandimet e paraqitura në raportin e Komisionit Vëzhgues të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare 2005. Komisioni parashikohet të përbëhet nga 18 anëtarë (9 nga shumica dhe 9 nga opozita parlamentare). Anëtarët që i përkasin shumicës parlamentare caktohen 3 nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, 2 nga Grupi Parlamentar i Partisë Republikane, 2 nga Grupi Parlamentar "Reformator-Demokristian", 1 nga Grupi Parlamentar i Partisë Agrare Ambientaliste dhe 1 nga Grupi Parlamentar "Qendra Demokrate". Anëtarët që i përkasin opozitës parlamentare caktohen 3 nga Partia Socialiste, 2 nga Partia Socialdemokrate, 2 nga Lëvizja Socialiste për Integrim, 1 nga Partia Aleanca Demokratike dhe 1 nga Partia Demokracia Sociale. Komisioni i Posaçëm Parlamentar drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një nga Partia Demokratike dhe një nga Partia Socialiste. Pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar duhet të ngrihet një grup ekspertësh teknikë. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të tij përcaktohen me vendim të Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

Vendimet në Komision merren me shumicën e votave (10 vota), kur pro tyre kanë votuar në unanimitet përfaqësuesit e dy partive të mëdha (3+3). Komisioni, parashikohet që të ushtronte veprimtarinë për një afat prej tre muajsh nga data e vendimit. Mbledhjen e tij të parë, Komisioni e zhvilloi më datë 23 maj 2006. Në këtë mbledhje u miratua edhe kalendari i punimeve të Komisionit me këtë përmbajtje:

1. Nxjerrja e përfundimeve mbi bazën e rekomandimeve të paraqitura në raportin e komisionit vëzhgues të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e vitit 2005.
2. Faza e parë e veprimtarisë së Komisionit të përqendrohet në përgatitjen dhe hartimin e amendamenteve të kodit zgjedhor që lidhen me zhvillimin e zgjedhjeve të pushtetit vendor.
3. Në vazhdimësi të dy pikave të para Komisioni gjatë të njëjtës periudhë do të realizojë dhe do të ndjekë punën për hartimin e listave të zgjedhësve për zgjedhjet e ardhshme parashikuar në pikën 2, dhe administrimi i propozimeve dhe programit të punës së komisionit për afatin e veprimtarisë së tij.

Mbledhja tjetër e radhës së Komisionit u bë më datë 24 maj 2006 me rend dite projektligjin "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9078 datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar". Opozita nuk i pranoi amendimet e paraqitura në komision nga qeveria lidhur me listat zgjedhore. Kjo solli dhe një bllokim të punës së komisionit për të reformës zgjedhore. Në mbledhjen e tij të radhës të datës 13 qershor, Komisioni për Reformën Zgjedhore diskutoi mbi një propozim të sjellë nga një grup deputetësh të opozitës. Përfaqësuesit e mazhorancës në Komision, kundërshtuan propozimet e opozitës, duke theksuar se këto propozime nuk garantojnë lista më të mira. Përgjegjësia për mbarëvajtjen e zgjedhjeve, -sipas tyre, - është e atyre që i organizojnë ato dhe nuk mund të arrihet asnjë konsensus mbi një zgjidhje që shkel të drejtën për të qenë zgjedhës dhe për të

votuar. Deputetët e opozitës, nga ana e tyre, e konsideruan regjistrin e përkohshëm të papranueshëm dhe mundësi për manipulim. Në Komision u diskutua dhe propozimi i z. Peçi, sipas të cilit, të gjithë personat që kanë mbushur moshën e votimit por familja e tyre është në regjistrin e përkohshëm, të regjistrohen në regjistrin themeltar të gjendjes civile. Ky propozim u mbështet nga mazhoranca, si një rrugë që do të çojë drejt eliminimit të regjistrit të përkohshëm dhe do të bëjë regjistrin themeltar si burim të vetëm informacioni për zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Opozita në lidhje me propozimin u shpreh se kjo është një nxitje, për të bërë transferimin në gjendjen civile, për të gjithë banorët që janë të regjistruar në regjistrin e përkohshëm. Në fund të mbledhjes mazhoranca theksoi se projektligji i sjellë nga opozita është një shprehje e zyrtarizuar e qëndrimit të opozitës, i cili pengon hartimin në kohë të listave, kryerjen e reformës dhe demton zgjedhjet e ardhshme. Të dyja palët u shprehën se Komisioni do të mblidhet pasi ato të kenë reflektuar mbi propozimet e njëra-tjetrës.

Në fund të muajit qershor opozita deklaroi në seancë plenare se nuk bashkëpunon për reformën zgjedhore pa u rënë dakord për eliminimin e regjistrit të përkohshëm. Më 28 korrik, Kuvendi zgjedh një anëtar të KQZ-së një kandidat të propozuar nga partitë e vogla të spektrit të djathtë. Opozita pretendon se ky anëtar i takonte partive të vogla të spektrit të majtë dhe se, në këtë mënyrë, është shkelur Kodi Zgjedhor. Opozita deklaroi se nuk do të bashkëpunonte derisa të plotësoheshin kërkesat e saj lidhur me listat zgjedhore dhe anëtarin e KQZ-së.

Më datë 31 gusht, 2006 pas ndërmjetësimit të faktorit ndërkombëtar përfaqësues të mazhorancës dhe opozitës firmosin një marrëveshje e cila i hapi rrugë bashkëpunimit të partive parlamentare lidhur me procesin e reformës zgjedhore si një ndër pikat kryesore të marrëveshjes.

Në seancën e parë të Kuvendit, të sesionit të III-të të Legjislaturës së XVII-të,

më datë 4 shtator 2006, Kryetarja e Kuvendit znj. Topalli deklaroi në fillim të seancës se "në këtë sesion të ri, ky Parlament do të punojë për formalizimin e marrëveshjes së arritur mes mazhorancës dhe opozitës, fryt i bashkëpunimit institucional parlamentar, çka më forcon bindjen se, brenda kësaj sale i kemi të gjitha hapësirat dhe mundësitë të gjejmë zgjidhjet e duhura për të arritur më të mirën." Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Pandeli Majko, lexoi një deklaratë të këtij grupi parlamentar në të cilën vlerësohej se fryma e bashkëpunimit dhe e konsensusit absolut duhet të karakterizojë të gjitha përpjekjet e përbashkëta, veçanërisht ato për reformën zgjedhore. Në vijim, Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Bamir Topi, duke falenderuar kolegët e mazhorancës dhe të opozitës për gjetjen e forcës dhe të vullnetit politik për t'u futur në dialog, u shpreh se mazhoranca është e gatshme t'i qëndrojë besnike marrëveshjes dhe ftoi deputetët të miratojnë shtyrjen e afatit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar, me qëllim arritjen e standardeve bashkëkohore. Në këtë seancë u shqyrtua projektvendimi për shtyrjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore. Me shumicë votash, deputetët miratuan projektvendimin për shtyrjen e afatit të Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore deri më 15 tetor 2006.

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Këshillin Konsultativ të Biznesit"

(Vijon nga faqja 1)

nature janë shpjeguar, në mënyrë të hollësishme, nga studimi i organizuar në vitin 2003, nga shoqëria këshilluese J.E. Austin Associates Inc (JAA), financuar nga programi i zhvillimit të ndërmarrjeve të Europës Juglindore (SEED).

Në këtë projektligj reflektohen rekomandimet e kësaj shoqërie.

Në kreun e parë të projektligjit "Dispozita të përgjithshme", përcaktohen qëllimi dhe veprimtaria e Këshillit Konsultativ të Biznesit.

Qëllimi i projektligjit është krijimi i një organi konsultativ për qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, i cili do të shërbejë si një kanal zyrtar institucional, ku mund të shprehen interesat e biznesit, duke nxitur zhvillimin e politikave të biznesit dhe të investimeve.

Objekti i veprimtarisë së Këshillit Konsultativ të Biznesit është përgatitja e rekomandimeve për qeverinë dhe Kuvendin, për hartimin e strategjive, politikave, programeve, që bëjnë të mundur zhvillimin e mëtejshëm të klimës së biznesit dhe të investimeve, në përputhje me programin e qeverisë.

Gjithashtu, pjesë e objektit të veprimtarisë së këtij këshilli është paraqitja e problemeve dhe e praktikave, ligjore dhe administrative, që pengojnë zhvillimin e klimës së biznesit.

Po në këtë kre jepen dhe burimet e financimit të këtij këshilli, të cilat do të jenë fonde financiare nga buxheti i shtetit, i miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, kryesisht për pagat e sekretariatit teknik, dhe burime të tjera, të ligjshme, të cilat janë financime nga vetë dhomat e tregtisë, nga biznese të ndryshme private etj.

Në kreun e dytë të projektligjit përcaktohen përbërja, emërimi dhe funksionimi i këshillit. Në nenin 4, të këtij kreu përcaktohet se në këshill ka një pjesëmarrje të gjerë përfaqësuesish nga komuniteti i biznesit, nga institucionet shtetërore, pushteti vendor dhe shoqëria civile, duke caktuar një numër në kufirin nga 15-20 anëtarë, me një mandat zgjedhor 2- vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Këshilli Konsultativ i Biznesit kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë, i cili emëron edhe anëtarët e këtij këshilli.

Mënyra e funksionimit dhe procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit përcaktohen në rregulloren, e cila është e parashikuar të miratohet nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Në nenin 7 është parashikuar që veprimtaria administrative e Këshillit Konsultativ të Biznesit të realizohet nga sekretariati teknik, i cili emërohet nga kryetari i këtij këshilli. Kjo strukturë do të mundësojë punën e këshillit për një veprimtari të planifikuar dhe frytdhënëse.

Ky projektligj do të ndikojë në përmirësimin e funksionimit të Këshillit Konsultativ të Biznesit.

PROJEKTLIGJ PËR

KËSHILLIN KONSULTATIV TË BIZNESIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kustututës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Këshilli Konsultativ i Biznesit është organ këshillimor, buxhetor, i qeverisë, për zhvillimin e politikave

ekonomike dhe për përmirësimin e kuadrit ligjor përkatës.

Neni 2 Objekti i veprimtarisë

1. Objekti i veprimtarisë së Këshillit Konsultativ të Biznesit është përgatitja e rekomandimeve për qeverinë dhe Kuvendin, nëpërmjet dialogut shtet-privat në:

- procesin e hartimit të strategjive dhe të programeve qeveritare të zhvillimit të ekonomisë;

- procesin e përgatitjes së buxhetit të shtetit dhe të paketave fiskale;

- politikat e privatizimit;

- politikat e prokurimit publik;

- politikat e nxitjes së investimeve;

- politikat e zhvillimit të tregtisë dhe të biznesit;

- politikat e konkurrencës, mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së konsumatorëve.

2. KKB-ja ia dërgon përfundimet dhe rekomandimet e saj Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Projektaktet e përgatitura nga institucionet qendrore të administratës, sipas objektivave të përcaktuara, në pikën 1, të këtij neni, i dërgohen për mendim KKB-së.

Neni 3 Burimet e financimit

Burimet e financimit të KKB-së janë:

- Buxheti i Shtetit;

- Burime të tjera të ligjshme.

KREU II

PËRBËRJA, EMËRIMI I ANËTARËVE DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLIT KONSULTATIV TË BIZNESIT

Neni 4 Përbërja e Këshillit Konsultativ të Biznesit

1. Këshilli Konsultativ i Biznesit kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe ka në përbërje përfaqësues nga:

- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë;

- shoqatat e biznesit, vendase dhe të huaja;

- shoqëria civile;

- institucionet shtetërore;

- organizmat e pushtetit vendor.

2. Këshilli Konsultativ i Biznesit përbëhet nga jo më pak se 15 dhe jo më shumë se 20 anëtarë. Kryetari e përfaqëson këtë këshill në marrëdhënie me të tretët. KKB-ja varon nëpërmjet komisioneve të këshillimit dhe sekretariatit teknik.

Neni 5 Mënyra e funksionimit

Mënyra e funksionimit dhe e përdorimit të fondeve financiare të KKB-së, komisioneve të këshillimit dhe sekretariatit teknik përcaktohen në rregulloren "Për funksionimin e Këshillit Konsultativ të Biznesit".

Rregullorja e funksionimit të Këshillit Konsultativ të Biznesit miratohet nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Neni 6 Emërimi i anëtarëve të Këshillit Konsultativ të Biznesit dhe kohëzgjatja e mandatit të tyre

Anëtarët e Këshillit Konsultativ të Biznesit emërohen nga ministri përgjegjës për ekonominë, sipas kriterëve dhe procedurës së parashikuar në rregulloren e funksionimit të këtij këshilli, për një periudhë 2-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 7 Sekretariati teknik

Veprimtaria administrative e Këshillit Konsultativ të Biznesit realizohet nga sekretariati teknik, i cili emërohet nga kryetari i këtij këshilli.

Neni 8 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

NGA MBLEDHJET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR MUAJIN GUSHT 2006

I. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE datë 16.08.2006

VENDIME për propozime projektligjesh

1. Për Ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe qeverisë së Republikës së Italisë të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme për realizimin e programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës"
2. Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë "HACI SAKIR SABUN VE GLISERINE FABRIKALARI TURK ANONIM SIRKETI», Stamboll, Turqi, për riskedulimin e borxhit".

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 16.08.2006

1. Disa shtesa në vendimin nr.241, datë 20.4.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për Shpronësimin për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tri Urat-Çarshovë, në territorin e qarkut të Përmetit" për fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës "BOT", të hidrocentralit të Skaricës sipas propozimit të pakërkuar.
2. Kthimin e fondeve financiare nga subjektet që përfitojnë nga përdorimi i fondit kundërparti të granteve Japoneze, për projektin "Rritja e prodhimit, 2KR" dhe për një ndryshim në vendimet nr. 479, datë 19.7.2001, nr.373, datë 5.6.2003, dhe nr.114, datë 25.2.2005, të këshillit të Ministrave.
3. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike në Republikën Islamike të Afganistanit.
4. Disa ndryshime në vendimin nr.167, datë 29.3.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për disa çështje në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, "Për Sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".
5. Skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për makineritë dhe pajisjet e importuara si edhe energjinë elektrike të importuar nga KESH SH.A-ja.
6. Kalimin e disa mjediseve në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Integritimit për ushtrimin e veprimtarisë.
7. Njehsimin e funksioneve organike sipas gradave në strukturën e Gardës së Republikës së Shqipërisë.
8. Pagat sipas gradave për punonjësit oficerë dhe nënoficerë të Gardës së Republikës së Shqipërisë.

II. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE datë 23.08.2006

VENDIME për propozime projektligjesh

1. Për ratifikimin e protokollit për pranimin e komunitetit Europian në Konventën Ndërkombëtare të Eurokontrollit për Bashkëpunimin për Sigurinë e Navigimit Ajror të 13 dhjetorit 1960, të ndryshuar me anë të amendimit dhe të konsoliduar nga protokollit i 27 qershorit 1997".

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 23.08.2006

1. Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.
2. Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetësore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Hysgjokaj të qarkut të Fierit.
3. Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Allkaj të qarkut të Fierit.
4. Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Grabian të qarkut të Fierit.
5. Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Burrel të qarkut të Dibrës.
6. Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Guri i Zi të qarkut të Shkodrës.
7. Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Krujë të qarkut të Durrsit.
8. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për mbështetjen e aksionit të UNESCO-s "Për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e pasurive të trashëgimisë kulturore të Kosovës".
9. Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit "Programi Iliria", ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane për futjen e gjuhës italiane në sistemin parauniversitar shqiptar.
10. Për disa ndryshime në vendimin nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave "Për ceremonia-lin zyrtar të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.
11. Për ngritjen e monumentit të heroit të demokracisë Azem Hajdari në qytetin e Tiranës.
12. Për kalimin e disa mjediseve në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për Agjensinë e Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI).

(vijon në faqen 5)

NGA MBLEDHJET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR MUJIN GUSHT 2006

(Vijon nga faqja 4)

13. Për miratimin e strukturës së autoritetit të mbikqyrjes financiare për vitin 2006.

14. Për një ndryshim në vendimin nr.267, datë 10.05.2006 të Këshillit të Ministrave, “për caktimin e ekspertëve financiarë në shoqëritë huamarrëse në administrim”.

III. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE datë 31.08.2006

VENDIME për propozime projektligjesh

1. Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së republikës së Italisë për financimin e programit “Rehabilitimi i rrugës Shkodër-Hani Hotit”.

2. Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin shumëpalësh të konventës “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave (CMR)”.

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 31.08.2006

1. Për një shtesë në vendimin nr.305, datë 24.05.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportive dhe mënyrën e shpërbimit të sportistëve që arrijnë këto nivele”.

2. Për zbatimin e Ligjit nr. 9588, datë 25.07.2006, “Për rillogaritjen e Pensioneve”.

3. Për një shtesë në vendimin nr.56, datë 28.01.2005, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e marzheve të fabrikimit dhe të tregtimit të barnave”.

4. Për disa shtesa në vendimin nr.523, datë 01.08.2003, të Këshillit të Ministrave “Për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave dhe të certifikatave të fituara në shkollat e larta të huaja”.

5. Për lejimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë” për blerjen e pullave në hologramë.

6. Për përbërjen e Komisionit të Kualifikimit Shkencor.

7. Për miratimin në parim me shkëmbim notash të pranimit për shtyrjen e vlefshmërisë së marrëveshjes së bashkëpunimit dypalësh për programin pesëvjeçar të zhvillimit 2002-2006, ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë.

8. Për miratimin e tarifave të shërbimit “Posta direkte”.

9. Për miratimin, në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Bullgarisë për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, krim-it të organizuar, trafikimit të paligjshëm dhe akteve të tjera kriminale.

10. Për disa ndryshime në vendimin nr.158, datë 22.03.2001, të Këshillit të Ministrave “Për strukturën, organikën dhe nivelin e pagave të qendrës së publikimeve zyrtare”.

PROGRAMI I PUNIMEVE TË KUVENDIT 4 SHTATOR - 6 NËNTOR 2006

1. P/Ligji “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në punë të vështira”.

*- Paraqitur nga një grup deputetësh më
24.11.2005*

2. P/Ligji “Për nxitjen e investimeve private në sektorin elektroenergjitikë”. (Është shtyrë shqyrtimi më 5.06.2006 për arsye që të shqyrtohet kur të vijë edhe p/ligji nga Qeveria).

- Paraqitur nga një grup deputetësh të LSI-së, më 26.01.2006

3. Dekret nr. 4778, datë 16.02.2006 “Për kthimin e ligjit nr. 9467, datë 30.01.2006 “Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 13.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, të ndryshuar.

- Paraqitur më 17.02.2006

4. P/Ligji “Akti i Lirisë së Shtypit”.

*- Paraqitur nga deputeti N. Lesi, më
20.02.2006*

5. P/Ligji “Për një ndryshim të ligjit nr. 7941, datë 31.05.1995 “Për hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”.

*- Paraqitur nga një grup deputetësh
më 9.03.2006*

6. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar.

*- Paraqitur nga deputeti N. Lesi, më
3.04.2006*

7. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

- Paraqitur nga KM, më 6.06.2006

8. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në disa ligje organike”. (Është diskutuar, por është shtyrë votimi).

- Paraqitur nga KM, më 20.06.2006

9. P/Ligji “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”.

- Paraqitur nga KM, më 21.06.2006

10. P/Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8607, datë 27.04.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar.

- Paraqitur nga KM, më 29.06.2006

11. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

- Paraqitur nga KM, më 4.07.2006

12. P/Ligji “Për miratimin e Buxhetit Faktik të Shtetit të vitit 2005”.

- Paraqitur nga KM, më 5.07.2006

13. P/Ligji “Për ratifikimin e Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore”.

- Paraqitur nga KM, më 6.07.2006

14. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për

(vijon në faqen 6)

PROGRAMI I PUNIMEVE TË KUVENDIT

4 SHTATOR - 6 NËNTOR 2006

(Vijon nga faqja 5)

bashkëpunimin financiar 2004 "Programi i Sektorit të Energjisë" me një grant prej 9 000 000 eurosh".

- **Paraqitur nga KM, më 7.07.2006**

15. P/Ligji "Për Factoringun".

- **Paraqitur nga KM, më 7.07.2006**

16. P/Ligji "Për Këshillin Konsultativ të Biznesit".

- **Paraqitur nga KM, më 7.07.2006**

17. P/Ligji "Për ratifikimin e Konventës, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për shmangien e tatimeve të dyfishta, për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal".

- **Paraqitur nga KM, më 7.07.2006**

18. P/Ligji "Për artin skenik".

- **Paraqitur nga KM, më 12.07.2006**

19. P/Ligji "Për sistemin e taksave vendore".

- **Paraqitur nga KM, më 13.07.2006**

20. P/Ligji "Për çertifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore".

- **Paraqitur nga KM, më 13.07.2006**

21. P/Ligji "Për disa shtesa në ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- **Paraqitur nga KM, më 13.07.2006**

22. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 7971, datë 26.7.1995 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

- **Paraqitur nga KM, më 13.07.2006**

23. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit, për shërbimin ajror".

- **Paraqitur nga KM, më 13.07.2006**

24. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD), për financimin e programit për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale".

- **Paraqitur nga KM, më 18.07.2006**

25. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Suedisë për afatet dhe kushtet e përgjithshme të bashkëpunimit për zhvillim".

- **Paraqitur nga KM, më 18.07.2006**

26. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8618, datë 14.6.2000 "Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë".

- **Paraqitur nga KM, më 18.07.2006**

27. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e kontrollit të gripit të shpendëve dhe përgatitjes për parandalimin e pandemisë humane".

- **Paraqitur nga KM, më 21.07.2006**

28. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e Programit "Për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit:

Fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimit të kontrollit".

- **Paraqitur nga KM, më 21.07.2006**

29. P/Ligji "Për Inspektimin e Punës dhe Inspektoria-tin Shtetëror të Punës".

- **Paraqitur nga KM, më 24.07.2006**

30. P/Ligji "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

- **Paraqitur nga KM, më 25.07.2006**

31. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e Programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës".

- **Paraqitur nga KM, më 21.08.2006**

32. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë "HACI SAKIR SABUN VE GLISERINE FABRIKALARI TURK ANONIM SIRKETI" STAMBOLL, TURQI, për riskedulimin e borxhit".

- **Paraqitur nga KM, më 28.08.2006**

33. Paraqitja në Kuvend e raporteve të dy Komisioneve Hetimore, të cilëve u ka përfunduar afati i vep- rimitarisë së tyre.

34. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të PS-së për ngritjen e Komisionit Hetimor me qëllim "Vep- rimitarinë e KESH-sh.a. për prokurimet e energjisë ele- ktrike, nënshkrimin e kontratave".

35. P/Ligji "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit".

- **Paraqitur nga KM, më 1.08.2006**

36. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7643, datë 2.12.1992 "Për Inspektoria-tin Sanitar Shtetëror".

- **Paraqitur nga KM, më 3.08.2006**

37. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ushtarake grant, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë".

- **Paraqitur nga KM, më 7.08.2006**

38. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes shumë- palëshe "Për ngritjen e një rrjeti hekurudhor, të për- formacës së lartë, në Europën Lindore".

39. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e UNESCO-S, "Për mbrojtjen dhe zhvil- limin e larmisë së shprehjeve kulturore".

- **Paraqitur nga KM, më 7.08.2006**

40. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën ndërkombëtare kundër dopingut në sport, 2005".

- **Paraqitur nga KM, më 7.08.2006**

41. P/Ligji "Për ratifikimin e Protokollit për pranimin e Komunitetit European në Konventën Ndërko- mbëtare të Eurokontrollit, për bashkëpunimin për sig- urinë e Navigimit ajror, të 13 Dhjetorit 1960, të ndry- shuar me anë të amendimit dhe të konsoliduar nga Protokollit i 27 Qershorit 1997".

- **Paraqitur nga KM, më 30.08.2006**

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 1)

4. Miratimi i Kalendarit Trijavor të Punimeve të Kuvendit.

5. Projektvendim "Për shtyrjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për

Reformën Zgjedhore", ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 38, datë 18.05.2006.

VEPRIMTARI NË KOMISIONE:

5 Shtator – 11 Tetor 2006

1. P/ ligji "Për ratifikimin e Konventës së bashkëpunimit policor për Europën Juglindore".

· Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut

· Komisioni i Jashtëm

· Komisioni për Sigurinë Kombëtare

2. P/ ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2004 "Programi i Sektorit të energjisë" me një grant prej 9 000 000 eurosh".

· Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut

· Komisioni i Jashtëm

· Komisioni i Integritit

· Komisioni i Ekonomisë dhe Financave

· Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

3. P/ligji "Për ratifikimin e Konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për shmangien e tatimeve të dyfishta, për kapitalin dhe parandalimin e evazionit fiskal".

· Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut

· Komisioni i Jashtëm

· Komisioni i Ekonomisë dhe Financave

4. P/ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së

Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit, për shërbimin ajror".

· Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut

· Komisioni i Jashtëm

· Komisioni i Sigurisë Kombëtare

· Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

5. P/ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD), për financimin e Programit për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale".

· Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut

· Komisioni i Jashtëm

· Komisioni i Integritit

· Komisioni i Ekonomisë dhe Financave

· Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

6. P / ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e Kontrollit të gripit të shpendëve dhe përgatitjes për parandalimin e pandemisë humane".

· Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut

· Komisioni i Jashtëm

· Komisioni i Ekonomisë dhe Financave

· Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

7. P/ ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Suedisë për afatet dhe kushtet e përgjithshme të bashkëpunimit për zhvillim".

· Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut

· Komisioni i Jashtëm

· Komisioni i Integritit

· Komisioni i Ekonomisë dhe Financave

8. P/ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e Programit "Për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar për integrim në sistemin e Ballkanit. Fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimit të Kontrollit".

(Vijon në faqen 8)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 7)

- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut
 - Komisioni i Jashtëm
 - Komisioni i Integritimit
 - Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
- 9.** P/ ligji “Për Këshillin konsultativ të Biznesit”.
- Komisioni përgjegjës: *Komisioni i Ekonomisë dhe Financave*
 - Jep mendim: *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut*
- 10.** P/ligji “Për artin skenik”.
- Komisioni përgjegjës: *Komisioni për Edukimin, Kulturën dhe Mjetet e Informimit Publik*
- 11.** P/ ligji “Për sistemin e taksave vendore”.
- Komisioni përgjegjës: *Komisioni i Ekonomisë dhe Financave*
- 12.** P/ ligji “Për disa shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar.
- Komisioni përgjegjës: *Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*
- 13.** P/ ligji “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në punë të vështira”.
- Komisioni përgjegjës: *Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë*
- 14.** P/ ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8607, datë 27.04.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar.
- Komisioni përgjegjës: *Komisioni i Sigurisë Kombëtare*
 - Jep mendim: *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.*
- 15.** P/ligji “Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore”.
- Komisioni përgjegjës: *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut*
- 16.** P/ ligji “Për miratimin e Buxhetit Faktik të shtetit të vitit 2005”.
- Komisioni përgjegjës: *Komisioni për Ekonominë dhe Financat*
- 17.** P/ ligji “për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8618, datë 14.06.2000 “Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”.
- Komisioni përgjegjës: *Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*
- 18.** P/ ligji “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”.
- Komisioni përgjegjës: *Komisioni për Edukimin, Kulturën dhe Mjetet e Informimit Publik*
- 19.** P/ ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” të ndryshuar.
- Komisioni përgjegjës: *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut*
- 20.** P/ ligji “Për Factoringun”.
- Komisioni përgjegjës: *Komisioni për Ekonominë dhe Financat*
- 21.** P / ligji “Për një shtesë në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.
- Komisioni përgjegjës: *Komisioni për Ekonominë dhe Financat*
- 22.** P/ ligji “Për Inspektoriatin e Punës dhe Inspektoriantin Shtetëror të Punës”.
- Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë
- 23.** P/ ligji “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.
- Komisioni për Ekonominë dhe Financat

SEANCË PLENARE

E hënë, datë 11.09.2006, ora 18.00

- 1.** Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60’).
- 2.** Miratimi i proces verbalit të seancës plenare të datës 4.09.2006.
- 3.** P/ ligji “Për ratifikimin e Konventës së bashkëpunimit policor për Europën Juglindore”.
- 4.** P/ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD), për financimin e Programit për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale”.

(Vijon në faqen 9)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 8)

5. P/ ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2004 "Programi i Sektorit të energjisë" me një grant prej 9 000 000 eurosh".
6. P/ ligji "Për Këshillin konsultativ të Biznesit".
7. P/ligji "Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore".

SEANCË PLENARE

E enjte, datë 14.09.2006, ora 10.00

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare të datës 11.09.2006.
3. P/ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit, për shërbimin ajror".
4. P / ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e Kontrollit të gripit të shpendëve dhe përgatitjes për parandalimin e pandemisë humane".
5. P/ ligji "Për sistemin e taksave vendore".
6. P/ ligji "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në punë të vështira".
7. P/ligji "Për artin skenik".

SEANCË PLENARE

E hënë, datë 18.09.2006, ora 18.00

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare të datës 14.09.2006.
3. P/ ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Suedisë për afatet dhe kushtet e përgjithshme të bashkëpunimi për zhvillim".
4. P/ ligji "Për disa shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar.
5. P/ ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" të ndryshuar.
6. P / ligji "Për një shtesë në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

SEANCË PLENARE

E enjte, datë 21.09.2006, ora 10.00

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare të datës 18.09.2006.
3. P/ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e Programit "Për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar për integrim në sistemin e Ballkanit. Fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimit të Kontrollit".
4. P/ ligji "Për miratimin e Buxhetit Faktik të shtetit të vitit 2005".
5. P/ ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8618, datë 14.06.2000 "Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë".

SEANCË PLENARE

E hënë, datë 25.09.2006, ora 18.00

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i proces verbalit të seancës plenare të datës 21.09.2006.
3. Miratimi i Kalendarit 3 javor të punimeve të Kuvendit.
4. Pyetje dhe Interpelanca.
5. P/ ligji "Për librin në Republikën e Shqipërisë".
6. P/ligji "Për ratifikimin e Konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për shmangien e tatimeve të dyfishta, për kapitalin dhe parandalimin e evazionit fiskal".
7. P/ ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8607, datë 27.04.2000 "Statusi i Dëshmorit të Atdheut", të ndryshuar.

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator
Qendra e Studimeve Parlamentare/
Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdp.org